



Funded by  
the European Union



# PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

## SHQIPËRI - ITALI - AUSTRI

“MBËSHTETJE INSTITUCIONIT PËR PËRAFRIMIN E LEGJISLACIONIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE ME *ACQUIS* TË BASHKIMIT EVROPIAN”

2020-2021

### PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale është një fushë dinamike, e cila është gjithmonë në zhvillim. Në 25 maj të vitit 2018 hyri në fuqi Rregullorja e Përgjithshme e Bashkimit Evropian (BE) për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), e cila zëvendësoi Direktivën për mbrojtjen e të dhënave personale të vitit 1995. Synimi i GDPR është të garantojë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, në një kohë kur përpunimi i të dhënave në kuadër të zhvillimeve teknologjike është shumëfishuar që nga koha në të cilën u miratua Direktiva e vitit 1995.

Reforma përfshin gjithashtu edhe modernizimin e Vendimit Kuadër 2008/977/JHA në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në fushën penale, nëpërmjet miratimit të Direktivës së Policisë dhe shfuqizimit të vendimit 2008/977/JHA.

Për vetë rëndësinë që mbart kjo reformë dhe si një vend i cili aspiron integrimin në BE, Zyra e Komisionerit është përfutuese e projektit të binjakëzimit “*Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian*”.

Ky është një projekt binjakëzimi ndërmjet Italisë, Austrisë dhe Shqipërisë, i financuar nga Bashkimi Evropian në vlerën prej rreth 400.000 Euro, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit në BE, IPA 2017.

Në këtë projekt binjakëzimi, Zyra e Komisionerit bashkëpunon me Autoritetin Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*Autorità Garante per la Protezione dei Dati Personali*), mbështetur nga CSI-Piemonte, Itali dhe Instituti Ludwig Boltzmann për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, Austri.

## OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivi kryesor i projektit të binjakëzimit është forcimi i kapaciteteve institucionale të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri, lidhur me mbikëqyrjen dhe monitorimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Qëllimi specifik i projektit është të mbështesë Zyrën e Komisionerit në Shqipëri në përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare për të zbatuar këtë *acquis*.

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- ✓ Kuadër i ri ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- ✓ Forcim i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të ri ligjor;
- ✓ Ndërgjegjësim i kontrolluesve/përpunuesve për përmbushjen e këtyre detyrimeve ligjore.

## ZBATIMI I PROJEKTIT

Projekti i Binjakëzimit përbëhet nga **3 komponentë**.

### Komponenti 1

Ofron mbështetje për përafrimin e legjislacionit kombëtar shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680.

### Komponenti 2

Ofron për Zyrën e Komisionerit njohuritë dhe instrumentet organizative për të trajtuar sfidat e mundshme në lidhje me zbatimin e kuadrit të ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri, nëpërmjet trajnimeve, rritjes së kapaciteteve administrative të stafit për të menaxhuar kuadrin e ri ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ofrimin e njohurive të nevojshme dhe praktikave më të mira në lidhje me GDPR.

### Komponenti 3

Ofron të gjitha njohuritë dhe përditësimet e fundit në lidhje me ligjin e ri shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet trajnimeve të grupeve të veçanta, në fokus nga sektori publik, privat dhe shoqëria civile.

## “MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE” SI NJË E DREJTË KUSHTETUESE

- PRIVATËSIA është një nga të drejtat e tua themelore;
- Kjo e drejtë garantohet në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Të dhënat personale të qytetarëve përpunohen me pëlqimin e tyre dhe/ose sipas rasteve të parashikuara në ligji;
- Privatësia është e lidhur ngushtësisht me shërbimet bazike të jetës së përditshme si: aksesit në llogarinë bankare, postën elektronike, llogaritë në rrjetet sociale, si dhe në shërbimet online. Shkelja e privatësisë mund të pengojë përdorimin e këtyre shërbimeve;
- Përpunimi i të dhënave personale është motori jetik për zhvillimin e një shoqërie;
- Rritja e kulturës së privatësisë ndihmon në ushtrimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e individëve në mjedisin digjital që po jetojmë;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është institucioni përgjegjës që garanton zbatimin e legjisllacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Në rast shkelje të të dhënave personale, qytetarët mund të ankohen pranë Zyrës së Komisionerit.

## Integrimi në BE

- Shqipëria është një vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.
- Projekti ynë i Binjakëzimit luan një rol shumë të rëndësishëm, pasi mbrojtja e të dhënave personale është një nga fushat që kontribuon në procesin e integrimit të vendit në BE. Njëpërmjet miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, të përafuar me *acquis* të BE:
  - Garantohen standarde evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
  - Qytetarëve u garantohet një nivel kontrolli më i lartë mbi të dhënat e tyre personale, njëpërmjet integrimit të të drejtave të reja, ndër të tjera, “*të së drejtës për tu harruar*”, si një garanci në mjedisin online, që ofron mundësinë për fshirjen e të dhënave personale nga motorët e kërkimit;
  - Rritet “përgjegjshmëria” e kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin dinamik të përpunimit të të dhënave personale;
  - Garantohet një trajtim më i mirë i mbrojtjes së të dhënave në lidhje me sfidat e reja të privatësisë që rezultojnë nga përdorimi në rritje i mjeteve teknologjike, si dhe çarkullimit gjithnjë e më të madh të të dhënave personale në botën digjitale;
  - Krijohet një kuadër ligjor gjithpërfshirës duke garantuar edhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e tyre nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla;
  - Rritet besimi dhe kultura e qytetarëve mbi ushtrimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Cili është institucioni i **Komisionerit** për të **Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**?

Nëse konsideroni se e drejta juaj për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur ose të dhënat tuaja nuk janë përpunuar në mënyrën e duhur mund t'i drejtoheni këtij **institucioni** të **pavarur**, garantues i kësaj të drejte.

Për çfarë është **përgjegjës** ky **institucion**?

Monitoron dhe mbikëqyr legjislacionin nëpërmjet hetimeve administrative; zhvillon aktivitete ndërgjegjësuese me kontrollues/përpunues dhe qytetarë; ka qasje këshilluese për kontrolluesit; urdhëron **bllokimin, fshirjen, shkatërrimin** ose **pezullimin e përpunimit të paligjshëm** të të dhënave personale dhe nxjerr udhëzime për qartësimin e aktiviteteve të përpunimit dhe sigurimin e zbatimit të duhur të ligjit.

Si mund të **kontaktoj** me këtë **institucion**?

Adresa:  
**Pruga "Abdi Toptani", Nd.5,**  
Kodi postar 1001, **Tiranë.**

Si t'i **drejtohem** këtij **institucioni**?

Zyrën e Komisionerit mund ta kontaktoni edhe nëpërmjet:  
Postës elektronike/e-mail: **info@idp.al**  
Tel: **+355 4 22 37 200**  
Nr. i gjelbër: **08002050**